

URDHËR
Nr. 380, datë 6.9.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 564, DATË 19.11.2012 “PËR
HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË, NË
UNIVERSITETIN PRIVAT “ALBANIAN UNIVERSITY”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26/1.3.1, nenit 44/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 603, datë 24.8.2011 “Për ndryshimin e emrit të universitetit privat “UFO University”,

URDHËROJ:

I. Pika 1 e urdhrit nr. 564, datë 19.11.2012 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në universitetin privat “Albanian University”, ndryshohet si më poshtë:

1. Hapjen, në përputhje me vendimin nr. 348, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit (bashkëlidhur këtij urdhri), në universitetin privat “Albanian University”, të programeve të studimit të ciklit të tretë, studime të Doktoratës në: “Financë”, “E drejtë europiane dhe e kontratave”, “Psikologji klinike”, “Shkenca administrative” dhe “Marrëdhënie ndërkombëtare”.

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti privat “Albanian University”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj